



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 168, Datë 15.05.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË 25.11.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2270 KW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1361/1 prot., datë 12.05.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr.187 , datë 25.11.2019, mbi licencimin e shoqërisë “MP-HEC” në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270kW, i ndryshuar”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 25.11.2019, të ndryshuar me vendimin e bordit nr. 74, datë 22.04.2020, ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “MP-HEC” shpk., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 2270 KW për një afat 24 vjet e 2 muaj, me kusht që:
 - a. Shoqëria “MP-HEC” shpk, të depozitojë në ERE pas nënshkrimit, kontratën shitesë të koncesionit, në vijim të miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”.

b. Shoqëria “MP-HEC” shpk të depozitohet në ERE “Lejen e Shfrytëzimit të Ujit” të rinovuar në përputhje me parametrat e ndryshuar, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, para fillimit të operimit të veprës.

2. Shoqëria “MP-HEC” shpk të depozitohet në ERE informacion mbi statusin e çdo dokumenti/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto dokumenta/leje.

3. Shoqëria “MP-HEC” shpk të depozitohet në ERE dokumentacionin e kërkuar para fillimit të operimit të veprës.

4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1361 prot., datë 03.05.2023, shoqëria ka depozituar Kontratën Shtesë të Konkensionit Nr. 1780 Rep., dhe Nr. 556 Kol., datë 20.06.2022, për miratimin e kapacitetit instaluar 2270 kW dhe Vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Seman, me nr. 5, datë 06.03.2023, për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhimin hidroenergjetik për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k. me fuqi të instaluar 2270 kWh dhe Lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor me nr. 239 prot, datë 10.03.2023.
- Sa më sipër, me plotësimin e kushteve të vendosura në pikën 1, gërmat “a” dhe “b” si dhe pikën 3 të këtij vendimi, vlerësohet të shfuqizohen.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, rezulton se i vetmi dokumentacion që mbetet për t’iu nënshtrohet procedurës së rinovimit janë kontratat e qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar. Në këto rrethana vlerësohet që ky kusht të ndryshohet duke i lënë detyrë shoqërisë të depozitohet në ERE kontratat e qirasë të rinovuara, përkatësisht brenda datës 12.12.2025 kontratatën e rinovuar me Bashkinë Maliq dhe brenda datës 29.09.2027 kontratatën e rinovuar me Bashkinë Pogradec, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Gërmat “a” dhe “b” të pikës 1, si dhe pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 187/2019, i ndryshuar, shfuqizohen.
2. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

2. *Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara, përkatësisht brenda datës 12.12.2025 kontratën e rinovuar me Bashkinë Maliq, dhe brenda datës 29.09.2027, kontratën e rinovuar me Bashkinë Pogradec, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.*
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI